

VENDIM
Nr.151, datë 11.2.2009

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE (OBJEKTE), QË PREKEN NGA NDËRTIMI I
SEGMENTIT RRUGOR RRËSHEN-KALIMASH**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, dhe të nenit 8 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private (objekte), që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Rrëshen-Kalimash.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi 7 338 382 (shtatë milionë e treqind e tridhjetë e tetë mijë e treqind e tetëdhjetë e dy) lekë.
 4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 200 000 (dyqind mijë), të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.
 5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, 7 338 382 (shtatë milionë e treqind e tridhjetë e tetë mijë e treqind e tetëdhjetë e dy) lekë, të përballohet nga llogaria e veçantë e Ministrisë së Financave “Fondi i shpronësimeve”, në Bankën e Shqipërisë.
 6. Shpronësimi të fillojë më 20.2.2009 dhe të përfundojë më 20.4.2009.
 7. Pronarët që shpronësohen, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
 8. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të kryejë likuidimin e pronarëve, brenda afateve të përcaktuara në pikën 6 të këtij vendimi, sipas dokumentacionit të pronësisë dhe planimetrisë përkatëse.
 9. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR
RRËSHEN - KALIMASH

Nr.	Pronari			ZK	Nr. Pas.	Objekti vlëra lekë	Qyteti/ fshati	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri					
1	Eridan	Fran	Skana	2610	214/1	1052755	Mashterkor	Konfirmuar nga ZRPP
2	Nikoll	Ndue	Biba	2162	81/10	1395498	Klos	Konfirmuar nga ZRPP
3	Tonin	Mark	Prenga	3598	243	2618565	Thirre	Konfirmuar nga ZRPP
4	Nikoll	Gjon	Prenga	3598	244	2271564	Thirre	Konfirmuar nga ZRPP
		TOTALI				7338382		